

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 E martë, 25 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar

9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Së pari, u lutem palëve që të prezantohen.

14 Zoti Prokuror, kush është i pranishëm për ZPS-në?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

16 Sot për ZPS-në paraqiten Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore;

17 Julie Mann, Menaxhere e Lëndës; stazhierja jonë juridike; dhe

18 unë jam Ndhmësprokuror me emrin De Minicis.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Mbrojtësja e Viktimave.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

23 Mirëdita, të gjithëve. Sot përfaqësohemi nga Marie-Pier

24 Barbeau, Bashkëmbrojtëse dhe unë, Anni Pues.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

1 avokat, prezantohuni.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
4 mirë.

5 Zoti Mustafaj, më dëgjoni mirë.

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
8 procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykes  
9 numër I.

10 Sot, do të dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit të ZPS-së, me  
11 numër 4484, zoti Sejdi Veseli.

12 Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqëroheni  
13 dëshmitarin të hyjë në sallë.

14 Zoti Avokat, jeni ngritur në këmbë.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se është 4844.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos  
17 thashë ndryshe?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] 4484.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
20 desha të them 4484.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po ky është numri i saktë, e  
22 nderuar Gjykatëse.

23 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Uluni, ju lutem.

1           Zoti Veseli, mirëdita.

2           DËSHMITARI: Mirëdita.

3           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
4 se erdhët.

5           DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

6           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
7 se erdhët në Dhomat e Specializuara. Më dëgjoni në rregull

8           DËSHMITARI: Po.

9           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si  
10 jeni?

11          DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

12          KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit. Zoti Veseli, sot do të fillojmë me dëshminë  
14 tuaj. Ju kanë thirrur të jepni dëshmi para Dhomave të  
15 Specializuara në çështjen gjyqësore, Prokurori i Specializuar  
16 kundër Salih Mustafës për ta ndihmuar Trupin Gjykes të marrë  
17 vendim.

18          Në fillim do t'ju kërkoj që të bëni betimin solemn për të  
19 thënë të vërtetën. Pas secilës do t'ju bëjnë pyetje  
20 përfaqësuesit e Prokurorisë, pastaj përfaqësuesit e viktimave  
21 që marrin pjesë në procedurë dhe avokati i Mbrojtjes, në fund  
22 edhe ne, Gjykatësit.

23          Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime, zoti Veseli, sesi t'u  
24 përgjigjeni pyetjeve të cilat do t'jua bëjmë.

25          Zoti Veseli, ju lutem dëgjojeni me vëmendje secilën

1 pyetje nëse nuk e kuptoni, lirisht, mund të kërkonit që pyetja  
2 të përsëritet.

3 Duam të na thoni të vërtetën, të na tregoni se çfarë keni  
4 parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar ju vetë. Nëse  
5 nuk e keni parë apo dëgjuar ju vetë, duhet ta thoni këtë gjë  
6 dhe të na shpjegoni sesi e keni marrë vesh.

7 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve  
8 dhe kjo është e kuptueshme. Ju lutem të dëshmoni vetëm për atë  
9 sa ju kujtohen, pa hamendësuar. Nuk ka kurrfarë problemi nëse  
10 thoni "Nuk e di" apo "Nuk më kujtohet".

11 I kuptuat të gjitha këto, zoti Veseli?

12 DËSHMITARI: Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
14 dëshiroj t'ju jap disa këshilla praktike për dhënien e  
15 dëshmisë.

16 Të gjitha sa i themi këtu përkthehen dhe regjistrohen,  
17 prandaj është rëndësishme që të flisni pranë mikrofonit që  
18 keni përpara, të flisni ngadalë dhe të flisni qartë, në mënyrë  
19 që t'u jepni kohë përkthyesve të përkthejnë gjithçka.

20 Përgjigjen duhet ta filloni vetëm pasi ta ketë përfunduar  
21 pyetjen personi që ua bën atë pyetje. Pas përfundimit të  
22 pyetjes, numëroni me vete deri pesë dhe vetëm atëherë  
23 përgjigjuni, sepse kjo pauzë prej sekondash na jep mundësinë  
24 që të dëgjojmë siç duhet, të përkthejmë apo të regjistrojmë  
25 siç duhet atë që thoni ju.

1 Nëse keni pyetje, nëse ju nevojitet pushim, mjafton të  
2 ngrini dorën dhe unë e di që ju dëshironi të thoni diçka.

3 I kuptuat edhe këto, zoti Veseli

4 DËSHMITARI: Po. Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
6 mirë.

7 Siç e kërkon procedura për të gjithë dëshmitarët, do t'ju  
8 kërkoj tani që të lexoni vetë deklaratën solemne për të thënë  
9 të vërtetën. Ju rikujtoj se dhënia e dëshmisë së rreme përbën  
10 vepër penale që është në kompetencë të Dhomave të  
11 Specializuara.

12 Zonja asistente e sallës, ju lutem, ndihmoheni zotin  
13 Veseli me deklaratën solemne për të thënë të vërtetën.

14 DËSHMITARI: Ekselencë, deklaratën në këmbë, në këmbë. Dhe  
15 betimi në këmbë bëhet. Ne s'e bëjmë betimin ulun.

16 Betimi solemn.

17 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe  
18 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them  
19 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk  
20 dot të mbaj të fshehtë asnjë për të cilin kam dijeni.

21 DËSHMITARI: SEJDI VESELI

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit, zoti Veseli. Tani jeni nën betim për të thënë.

24 DËSHMITARI: A mund të ulem?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 mund të uleni.

2 Ju lutemi, mos harroni që të presim të mbarojë njëri para  
3 se të flasë tjetri. Kur dëshironi të thoni diçka, mos flisni  
4 ndërkohë që flet dikush tjetër, kjo është për arsye të  
5 përkthimit sepse ka mbivendosje në mënyrë që të dëgjojmë  
6 gjithçka.

7 U rikujtoj të gjithëve se kjo seancë mbahet në sesion të  
8 hapur, me përjashtim të rasteve kur e kërkojnë palët,  
9 Mbrojtësja e Viktimave apo kur e vendos Trupi Gjykses. Duhet  
10 të keni kujdes të mos nxirrni asnjë informacion konfidencial.  
11 Dhe kur dëshironi të nxirrni informacion konfidencial, ju  
12 lutem, të më informoni paraprakisht për të kaluar në seancë  
13 private apo të mbyllur, në funksion të pyetjeve tuaja apo në  
14 funksion të bërjes së parashtrime.

15 Mund të fillojmë atëherë me dëshminë e zotit Veseli duke  
16 filluar me ZPS-në.

17 Zoti Prokuror, ju lutemi informoheni Panelin nëse mendoni  
18 se do ju duhet më shumë apo më pak kohë nga ç'keni  
19 parashikuar, pra, nga katër orëshi.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse,  
21 faleminderit. Besoj se, më duket se dje, të hënën, kemi bërë  
22 rishikim të vlerësimit tonë duke e vlerësuar atë me dy orë.  
23 Mbase ky mesazh nuk ju ka ardhur ende, se jua dërguam me postë  
24 elektronike. Është faji im mbase.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

1 është punë faji. Ju falënderojmë që na informuat tani, mund të  
2 vazhdoni atëherë.

3 Keni fjalën.

4 Pyetje nga zoti De Minicis:

5 Py. Mirëdita, zoti Veseli. Më quajnë Filippo De Minicis.

6 Përfaqësoj ZPS-në sot këtu. Jemi takuar shkurtimisht dje.

7 Dëshiroj të fillojmë me emrin dhe mbiemrin për

8 procesverbalin. Emrin tuaj dhe mbiemrin.

9 Pë. Unë jam Sejdi Rexhep Veseli, i lindur më 1 janar 1949, në  
10 fshatin Gallap, Komuna e Besianës.

11 Py. Zoti Veseli, gjatë konfliktit në vitin 1998 dhe 1999, a  
12 keni qenë ndonjëherë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

13 Pë. Së pari, unë nuk e quaj konflikt. Ajo ka qenë luftë e  
14 armatosur çlirimtare. Na u ka imponuar. S'e kemi dashtë luftën  
15 kurrë, po na u ka imponu ose na ka ardhë thika në esht.

16 Përndryshe kam qenë dhe jam shumë krenar që kam qenë, nëse e  
17 lyp nevoja prapë do të jem.

18 Py. A mund t'i thoni Trupit Gjykses se kur apo rreth cilit  
19 moment i jeni bashkuar UÇK-së?

20 Pë. Në UÇK, kam ardhur nga Tirana më 25 dhjetor 1998.

21 Py. Është data kur u kyçët edhe në radhët e UÇK-së?

22 Pë. Po. Aktivisht. Përndryshe kam qenë prej themelimit, kam  
23 punu për UÇK-në.

24 Py. Në cilën zonë të Kosovës u kyçët në UÇK?

25 Pë. Në zonën Gallapit, përndryshe me emërtimin e vjetër është

1 Gollak.

2 Py. Ka ndonjë arsye të veçantë pse u kyçët në UÇK pikërisht  
3 në atë zonë?

4 Pë. Po, pikë së pari, është vendlindja ime ajo zonë edhe aty  
5 e kisha shokun e burgut, që kam qenë i dënum politikisht nga  
6 Serbia, Fatmir Sopin.

7 Py. Kush ishte ky shoku juaj që ishte aty në zonë?

8 Pë. Fatmir Sopi. Ishim dënuar bashkë politikisht me Fatmirin.

9 Py. Kur u kyçët në UÇK në zonën e Gollakut, u kyçët në ndonjë  
10 njësi të caktuar të UÇK-së?

11 Pë. Fillimisht kam pritur, natyrisht, s'mund me imponu njeri  
12 me u kyç pa të dhënë eprorët leje, deri kur ka fillu me u  
13 themelu Brigada 153. Dhe ajo ka qenë më 20 shkurt 1999, kur  
14 drejt për së drejti jam kyç e kam vesh uniformën e UÇK-së.

15 Py. Faleminderit. Na thatë që arritët në vitin 1998, në  
16 dhjetor të vitit 1998 nga Tirana.

17 Pë. 25 dhjetor.

18 Py. Dhe aso kohe ju bëtë hapat e parë për t'u kyçur në  
19 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës me të mbërritur aty?

20 Pë. Aktivisht në uniformën e UÇK-së, mbasi kam ardhur në  
21 Gollak. E përndryshe prej themelimit kam qenë një prej  
22 organizatorëve të formimit të saj.

23 Py. Dita kur veshët uniformën ishte 20 shkurti 1999, kur u  
24 krijua dhe Brigada 153?

25 Pë. U themelua ose ajo me u krijuar me krijimin e një njësie



1 madhore siç është brigada e zgjatë, po u themelue. Themelet e  
2 brigadës kanë qenë më 20 shkurt. Ajo lindja e saj, ka lind  
3 sikur foshnja.

4 Py. Faleminderit, zoti Veseli. Çfarë roli kishit ju në  
5 Brigadën 153?

6 Pë. U emërova zëvendëskomandanti i brigadës.

7 Py. Si zëvendëskomandant, mund t'i thoni Trupit Gjykues se  
8 çfarë funksionesh dhe çfarë roli luanit?

9 Pë. Unë rolin kryesor e kam luftë në përgatitjen e  
10 rregulloreve të brigadës. Se ajo ishte një njësi në themelim e  
11 sipër dhe natyrisht çdo organizim pa rregullore, nuk a  
12 organizim. Kështu që detyra ime ka qenë kryesore me përgatit e  
13 rregulloreve për njësitë varëse të Brigadës 153.

14 Py. Pra, ishit zëvendëskomandanti, a mund t'i thoni Trupit  
15 Gjykues kush ishte komandant kur u krijua apo u themelua  
16 brigada?

17 Pë. Fillimisht ishte vend vakant se pritej ardhja e  
18 komandantit nga Tirana, zoti Adem Shehu, një ushtarak i cili e  
19 lëshoi ushtrinë e rregullt shqiptare edhe erdhi u bashkue  
20 Ushtrisë Çlirimtare.

21 Py. Po kush vepronte në detyrën e komandantit deri në  
22 momentin sa erdhi zoti Shehu në zonën e Gollakut?

23 Pë. Po fillimisht, unë kur kam ardhë ka qenë e formuar njësia  
24 operative e Gollakut. Atë e ka formu Fatmir Sopi me Rrahman  
25 Dinin dhe kush tjetërkush nuk di. Por ajo veç ka qenë tuj

1 funksionue një njësi me grupe të vogla nëpër fshatra. Dhe  
2 detyra parësore e asajna ka qenë mbrojtja e popullatës, e cila  
3 ishte shpërngul nga terrori sistematik në atë pjesë që kanë  
4 qenë mbi 100.000 njerëz të vendosun nëpër shtëpitë e  
5 fshatarëve, nëpër të gjitha shkollat në pjesën e Gollakut dhe  
6 kanë qenë kryesorja mbrojtja e asaj popullate, ndihma, ushqimi  
7 i asaj popullate, trajtimi shëndetësor i asaj popullate. Kjo  
8 ka qenë veç atëherë.

9 Py. A ju kujtohet përafërsisht se kur erdhi komandant Shehu  
10 dhe mori zyrtarisht komandën e Brigadës 153?

11 Pë. Përafërsisht mbas dy javësh ka ardhur dhe ka marrë  
12 detyrën.

13 Py. Faleminderit, zoti Veseli. Do t'ju bëj tani disa pyetje  
14 sa i takon strukturës dhe funksioneve të Brigadës 153, mesa  
15 duket për të cilat duket që keni kujtesë të mirë.

16 Së pari, në cilën zonë operative bënte pjesë brigada 153?

17 Pë. Brigada 153 ishte pjesë e zonës operative të Llapit.

18 Py. Ku e kishte komandën, selinë, Brigada 153 në momentin e  
19 krijimit më 20 shkurt 1999?

20 Pë. Në momentin e krijimit Brigada 153 e ka pasur në shtëpinë  
21 e Fatmir Sopit, në Zllash. Fshati Zllash, përafërsisht 20  
22 kilometra larg Prishtinës.

23 Py. Si zëvendëskomandant, ju vetë, ishit i vendosur në  
24 shtëpinë e Fatmir Sopit aso kohe?

25 Pë. Po.

1 Py. Flinit dhe aty apo natën rrinit diku tjetër?

2 Pë. Aty kemi nejt. Në shtëpi tina kemi nejt.

3 Py. Nga oficerët e Brigadës 153, kush tjetër qëndronte në  
4 shtëpinë e Fatmir Sopit aso kohe?

5 Pë. Po nuk ka pasë oficerë. Ajo ka qenë në themelim e sipër.

6 Kanë qenë bashkëluftëtarët, ata të cilët ishin ka qenë në atë  
7 terren. Përndryshe oficer nuk ka pasë, se ka qenë në themelim  
8 e sipër. Kemi qenë -- s'e di, besoj e keni të qartë. Brigada  
9 153, po edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, nuk ka dalë nga  
10 kazerma, nuk ka dalë nga akademia ushtarake. Ka dalë nga gjiri  
11 i popullit i cili, populli, ja ka falë bijtë dhe bijat e tij  
12 se i ka ardhë thika në ashtë nga terrori sistematik nga  
13 ushtria, policia dhe paramilitarët serb.

14 Py. Faleminderit, për sqarimin. E kisha fjalën këtu, mbase  
15 për komandantët, ata që u ishte ngarkuar drejtimi. Ju  
16 qëndronit aty edhe zoti Sopi ishte i vendosur aty?

17 Pë. Po.

18 Py. Po zoti Shehu kur erdhi?

19 Pë. Edhe Shehu kur ka ardhë aty ka qendru. S'e di sa e  
20 kuptoni, po aty çdo shtëpi e Gollakut ka qenë ushtri. Ka qenë  
21 e shtrime me ushtrinë. Ka qenë çdo gjë e përbashkët. Keni  
22 parasysh, nënat tona kanë gatu edhe nëpër proje nëse është  
23 nevoja e ushtarët nuk i kanë lënë pa bukë. Kanë qenë, krejt  
24 populli komplet ka qenë i kyçun. I ka ushqy populli ata që  
25 kanë ardhë hallexhinjtë.

1 Bile, bile, është kushtu një interes shumë i madhe me  
2 siguru dhe sa qumësht pluhun vijjnë për nënat që kanë fëmin për  
3 gjinin.

4 Py. Brigada 153, a kishte ndonjë person që luante rolin apo  
5 detyrën e shefit të shtabit?

6 Pë. Fillimisht jo. Ka fundi, pak para përfundimit të luftës,  
7 unë e kam pasë atë detyrë.

8 Py. Të ecim një ose dy muaj përpara në kohë për të arritur  
9 tek prilli 1999. Atë kohë, a njihnit ju një njeri me emrin  
10 Rrahman Dini?

11 Pë. Po. Rrahman Dini ka qenë i organizum në organizatën time  
12 të përhershme moti, në 1984, në frontin nacional çlirimtar dhe  
13 ka qenë i dënum si i mitur. Ka qenë i sëmurë. Ka qenë me  
14 sëmundje të rëndë të zemrës, me astmë, me mushkëri të  
15 shkatërrume nga torturat që si fëmijë, si i ri që i ka  
16 përjetu. Dhe faktikisht edhe i ka pagu me jetë mbasandajna nga  
17 ajo sëmundje.

18 Py. Në ç'gjendje shëndetësore ishte ai rreth marsit dhe  
19 prillit të vitit 1999. Flasim për zotin Rrahman Dini?

20 Pë. Në gjendje shumë të keqe. Në kushte normale, ai do të  
21 dërgohej në emergjencë.

22 Py. Po u kujdes dikush nga ana mjekësore për atë aso kohe, me  
23 aq sa ishin mundësitë sipas rrethanave?

24 Pë. Po në mesin e popullit të shpërngulë ka pasë edhe mjekë  
25 që kanë ardhë. Edhe studentë absolvent të mjekësisë,

1 domethënë, na nuk kemi pasë spital, se spitalet edhe për  
2 qytetarët para se me ndjek kanë qenë të ndalume për neve.

3 Kështu që të gjithë jemi kujdes. Edhe unë jam punëtor  
4 shëndetësor edhe unë jam kujdes për shëndetin e tina.

5 Py. Rrahman Dini luante ndonjë rol aktiv operacional në mars  
6 -prill të vitit 1999?

7 Pë. Mu s'më kujtohet. Se s'ka qenë edhe në gjendje.

8 Py. Zoti Veseli, na thatë se rreth shkurtit të vitit 1999,  
9 shtëpia e Fatmir Sopit përdorej si qendër, si komandë, ju  
10 qëndronit aty Fatmir Sopi qëndronte aty, zoti Shehu qëndronte  
11 aty kur erdhi. Veç këtij vendit që përmendët ju, ndonjë  
12 ndërtesë tjetër a përdorej nga Brigada 153 në Zllash?

13 Pë. E kemi ndërruar më vonë. Kemi shku në shtëpinë e axhës së  
14 Fatmir Sopit, Sadik Sopit.

15 Py. Ndonjë ndërtesë apo ndonjë zonë vend i Zllashit ndodhej  
16 aty ku stërviteshin, ushtroheshin ushtarët, rekrutët e rinj?

17 Pë. Rekrutët e rinj janë ushtruar në shkollën e Zllashit. Ka  
18 qenë ana e kundërt e shkollës, ku nga kodrat përreth nuk kanë  
19 mujt me vëzhgue forcat e pushtuesit. Kështu që ka qenë vendi  
20 strehum. Janë kryer disa ushtrime bazike. A në shkollë mbrenda  
21 janë mbajtë edhe ligjëratat. Në mesin e tyre jam edhe unë që  
22 kam mbajtë katër ligjërata.

23 Py. Deri tani mësuam se Brigada 153, qendrën e kishte në  
24 Zllash dhe na treguat edhe vendet ku ndodhej aty. Po brenda  
25 zonës së Zllashit, a kishte njësi të tjera të UÇK-së të cilat

1 ishin të vendosura aty dhe ushtronin veprimtari prej aty?

2 Pë. Kanë qenë dy njësi të vendosura në Zllash. Ka qenë njësia  
3 operative e Karadakut, ka qenë afër 200 metra prej shtabit  
4 tonë dhe ajo ka qenë në themelim e sipër si zonë operative.  
5 Dhe kanë qenë një grup i gueriljes së qytetit që janë quajtur  
6 BIA.

7 Veç ta shpjegoj. BIA kanë qenë germat e para të tre  
8 dëshmorëve, Bahriu, Iliri dhe Agroni të cilët kanë ranë në  
9 luftë.

10 Py. Kush ishte komandant i njësitit BIA në periudhën mars-  
11 prill 1999?

12 Pë. Sa di unë ka qenë Salih Mustafa.

13 Py. Salih Mustafa a njihej me ndonjë emër tjetër a nofkë  
14 gjatë luftës?

15 Pë. Kam dëgju që e kanë thirrë Cali, por unë se kam thirrë  
16 Cali kurrë. E kam thirrë Salih.

17 Py. Harrova t'ju pyes më përpara. Po ju vetë njiheshit me  
18 ndonjë emër tjetër apo noftkë gjatë asaj kohe?

19 Pë. Jo.

20 Py. Po Baci?

21 Pë. Jo, Baci kam qenë në kohën e ilegales para luftës. Mbas  
22 luftës Baci e ka marrë tjetërkush e ka marrë atë nofkë.

23 Py. Ju kuptoj. Faleminderit. Gjatë kohës, që prej momentit që  
24 ju jeni keni mbërritur në rajonin e Gollakut dhe morët pozitën  
25 e zëvendëskomandantit në 1999, a e takuat ndonjëherë, u hasët

1 me Salih Mustafën ndonjëherë aty në atë zonë?

2 Pë. Po.

3 Py. Njësiti BIA, a ishte pjesë -- ose më lini ta formuloj  
4 ndryshe. Njësiti BIA, a ishte pjesë e komandës së Brigadës  
5 153?

6 Pë. Jo. Ajo as nuk i ka raportu brigadës. Ajo ka qenë drejt  
7 për së drejti e zonës operative të Llapit dhe është quajjt  
8 "guerilja e qytetit". E në Zllash kanë ardhë me u strehë se  
9 ka qenë shumë rrezik qëndrimi në qytet, se ka qenë kontrolli  
10 shumë i madh i policisë. Kështu që e kanë shfrytëzuar për  
11 strehim dhe për rehabilitim të ushtarëve.

12 Py. Pra, mendoj që ju përmendët guerilen. A mund t'i thoni  
13 Gjykatës se çfarë roli ka pasur njësiti BIA gjatë konfliktit,  
14 domethënë, çfarë detyrash, çfarë roli ka pasë njësiti BIA  
15 gjatë asaj kohe?

16 Pë. Ka qenë si çdo guerile mbrena qytetit, Prishtinën,  
17 eventualisht edhe Podujevën.

18 Py. Ju i treguat Gjykatësve që njësiti BIA ka pasur  
19 gjithashtu një bazë në Zllash. Ku në Zllash? Në çfarë vendi  
20 ekzaktësisht në Zllash e kishte bazën njësiti BIA?

21 Pë. Në veri të fshatit Zllash, një shtëpi, ka qenë disa  
22 shtëpia të vetmuara, pa rrethoja, shpia të vjetra të lëna nga  
23 pronarët kanë qenë të shprasta. Natyrisht me pëlqimin e tyre  
24 janë shfrytëzuar çdo gjë që është përdorë aty. Pa e marrë  
25 pëlqimin e banorëve ne nuk i kemi shfrytëzuar. Bile-bile po jua

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 16

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 them një, besoj që hyn në punë juve, që ne kemi ditë me marrë  
2 miellin në krah dhe enë në krah dhe me gatu vetë edhe mos me  
3 ngarku popullin.

4 Py. Në qoftë se do të ishit në shkollë dhe duhej që të  
5 shkonit tek baza e njësitit BIA, i duhej që të shkonit lart  
6 kodrës, të ngjiteshit kodrës apo të zbrisnit poshtë?

7 Pë. U dush djathtas prej shkollës në një kand, ndoshta 45  
8 shkallë, rreth një kilometër a diçka, gati 2 kilometra. Një  
9 kilometër a diçka ka qenë ajo shtëpia.

10 Py. Ishe në një sipërfaqe pak më të ngritur, më të përpjetë?

11 Pë. Kodra afër. E ka pasë pikën trigometrike ku ka qenë kodra  
12 më e lartë në atë pjesë.

13 Pyetje. Ju vetë, personalisht, a keni hyrë në këtë vendin që  
14 përshkruat dhe që thatë që kishte disa shtëpi?

15 Pë. Asnjëherë s'kam hy.

16 Py. Kush ishte përgjegjës për këtë bazën për këtë kompleksin?

17 Pë. Sa di unë ka qenë komandant Salihu, ajo thuhesh ka qenë  
18 përgjegjësi. Nuk di kush tjetër kush.

19 Py. Ndonjë prej ushtarëve tuaj, a ishin të vendosur në këtë  
20 bazë, domethënë, e kam fjalën këtu për ushtarët e Brigadës  
21 153?

22 Pë. Jo, jo.

23 Py. Ju na thatë që nuk keni qenë atje vetë, por ndoshta për  
24 shkak të pozitës tuaj mund ta dini përgjigjen. Sa ushtarë të  
25 BIA-s qëndronin në atë bazë, pra, sa ushtarë të BIA-s kishte



Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 17

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 në atë bazë?

2 Pë. Zotëri, unë i përmbana disa parimeve strikte ushtarake.

3 S'i kam leju as me u interferu dikush mbrenda brigadës, as unë

4 s'kam dasht të interferoj mbrenda njësisë tjetër. S'ka qenë

5 detyrë e imja. S'kam qenë shërbim informativ ushtarak. Kështu

6 që ato s'i kam leju vetvetes. S'e kam dashë me pru vetveten,

7 domethënë, pse po përzihesh. Dhe nuk jam marrë me punë tjera

8 tjetërkujt.

9 Py. Faleminderit. Nuk është se po nënkuptoja ndonjë ndërhyrje

10 edhe nuk është se të pyeta në qoftë se ke ndërhyrë apo jo.

11 Thjesht, të pyeta në qoftë se e dije mesatarisht se cili ishte

12 numri i anëtarëve të BIA-s që qëndronin në atë kompleks.

13 Pë. Për mu ka qenë parësore t'i përpunoj informatat nga

14 terreni për lëvizjet e forcave serbe, që për çdo ditë shihej

15 pozicionimi i tyre që veç fillojshin të ndërtonin rrethimin.

16 Py. Në rregull.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

18 Prokuror, ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres, por po shoh

19 transkriptin në faqen 14, rreshti 21. Pra, thjesht dua që të

20 sigurohem që bëhet fjalë për një problem të përkohshëm në

21 përkthim, në transkript, por nuk e dëgjova as vetë shumë qartë

22 përmes përkthimit. Kush ishte përgjegjës për bazën kështu që

23 do të doja që kjo pyetje t'i përsëritet dhe njëherë

24 dëshmitarit.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

1 Py. Zoti dëshmitar, zoti Veseli, zonja Kryetare dëshiron që  
2 ju të na thoni dhe njëherë, e di që na e dhatë përgjigjen, por  
3 dua ta thoni edhe njëherë përgjigjen se kush ishte përgjegjës  
4 për bazën e BIA-s në Zllash?

5 Pë. Po i përgjigjem Ekselencës, ka qenë Salih Mustafa.

6 Py. Faleminderit zotëri.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, zoti Prokuror. Faleminderit, gjithashtu, zoti  
9 dëshmitar.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 Py. Zoti Veseli, përveç Salih Mustafës, ju personalisht a  
12 njihni ndonjë person tjetër, ndonjë anëtar tjetër të njësimit  
13 BIA?

14 Pë. Jo. Përveç njërit, i cili ka ardhë nga Tirana dhe për të  
15 cilin ruaj kujtimet më të mira si djalë shumë të ndershëm,  
16 Bahri Gashin. Që të vetmin atë e kam njoftë.

17 Py. Bahri Gashi --

18 Pë. Po.

19 Py. -- ishte pjesë, ishte anëtar i njësimit BIA, apo jo?

20 Bazën ky e kishte në Zllash?

21 Pë. Ai ka qenë -- e kam pa edhe ty kur ka ardhë në Zllash, po  
22 ata kanë udhëtu për çdo ditë janë ndryshue. Kanë shku në qytet  
23 janë kthy prej qytetit. Kështu që ai ka qenë një bazë për  
24 rehabilitimin e ushtarëve. Shkurt, ka kanë veç për pushimin e  
25 ushtarëve.

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje nga z. De Minicis

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 Py. Juve sapo thatë që Bahri Gashi ishte një burrë shumë i  
2 ndershëm, domethënë, i takon që juve keni vlerësim goxha të  
3 lartë për këtë person. Çfarë mendonit ju për anëtarët e tjerë  
4 të njësimit BIA?

5 Pë. Unë nuk i kam njoftë. Por po e them shumë troç, kur kam  
6 digju disa pseudonime që janë përdorë, për mua ato nuk kanë  
7 flejtë në vakabolarin tim, si Tabuti e Vdekja, këto për mua  
8 nuk janë ato të natyrës time. Kështu që nuk di më shumë për  
9 ta, por edhe që s'kam dashtë as ti njoh atëherë me asi  
10 pseudonimi. Se dikush 20 vjet tjera kësi pseudonimi, unë as që  
11 du me u njoftu me të.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë  
13 se mund të më lejoni lidhur me këtë çështje që rifreskoj  
14 kujtesën e dëshmitarit lidhur me disa komente që ka bërë për  
15 Bahri Gashin dhe disa persona të tjerë që ka përmendur gjatë  
16 intervistës së dhënë për ZPS-në.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
18 lutem, vazhdoni.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di  
20 në qoftë se mund të shfaqet në ekran, në anglisht dhe më pas  
21 do ta lexoj tekstin dhe përkthyesi do të përkthejë dëshminë.  
22 Do të doja që të shfaqet në ekran pjesa e dytë, deklarata me  
23 numër 069889-TR-ET. Duke filluar nga faqja 13, ju lutem.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
25 Sekretare, ju lutem nxirreni në ekrane këtë dokument.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 Py. Zoti Veseli, do të lexoj një pjesë të pyetjeve dhe  
3 përgjigjeve të një shkëmbimi që keni pasur me Prokurorin në  
4 intervistimin që ju është bërë me datë 27 nëntor 2019.

5 Prokurori ju pyet:

6 "A keni kontaktuar me ndonjë anëtar tjetër të njësitit  
7 BIA përveç Salih Mustafës?"

8 Përgjigja juaj është kjo:

9 "Ishte një i ri. Një i ri i mirë i cili ishte manipuluar  
10 prej tyre. Dhe ai ishte me mua në Tiranë".

11 Dhe juve thoni që ky person i ndershëm, njeriu i mirë  
12 ishte Bahri Gashi.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më pas në faqen 14.

14 Py. Prokurori, në rreshtin 17, ju pyet:

15 "Mbi çfarë baze thoni ju që e përdorën ose e manipuluan  
16 atë?"

17 Ti thua që:

18 "Ata e manipuluan atë sepse, së pari, nuk mund ta besoj  
19 që ai ka qëndruar krahë për krahë me hajdutët".

20 Zoti Veseli, a mund t'ju kërkoj që të na e shpjegoni pak  
21 më shumë këtë deklaratë, këtë pasazh? Çfarë doni të thoni që  
22 nuk e besoni që një burrë i mirë si Bahri Gashi nuk mund të  
23 qëndronte krah për krah me hajdutët, me hajnat?

24 Pë. Është shumë qartë. Është folë që jo janë hajdutë. Kështu  
25 në emnat pasi që si njoh. Nuk e di me çka u marrë ai personi,

1 tjetri, por është folë qenë hajdut. Edhe mua si individ nuk  
2 mund të më bind kërrkush që Bahri Gashi bien në atë nivel.  
3 Py. Për kë thonin njerëzit që është hajnë apo hajdut? Kujt i  
4 drejtohesh?

5 Pë. Po ata që ngjesin nofka Tabuti, Vdekje e këto, për mue  
6 s'është -- për mue një njeri normal nuk i gjet vetja emnin  
7 Vdekje.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di  
9 në qoftë se mund të më lejoni që të lexoj një tjetër pasazh të  
10 shkurtër të transkriptit?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
12 mund të vijoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëhere, ky segment është në  
14 faqen 14 duke filluar nga rreshti 23.

15 Py. Ju deklaroni, zoti Veseli se:

16 "Kishte individë që kishin nofkën Tabuti, Vdekja edhe  
17 kishte dhe kriminelë që kishin rekorde kriminale për gjithë  
18 jetën e tyre. Domethënë, me fjalë të tjera nuk mund të shkoje  
19 në asnjë vend në botë, në tokë me këta njerëz. Kështu që  
20 Bahriu është një njeri i mirë. Pra, këta janë persona me të  
21 cilët ti nuk do të qëndrosh. Kështu që ai është manipuluar".

22 Pra, këta njerëzit që ju i keni përmendur të tillë si për  
23 shembull, Tabuti, Vdekja, këta njerëz a ishin anëtarë të  
24 njësimit BIA?

25 Pë. Sa di kanë qenë anëtarë të njësimit BIA. S'i kam njoft

1 personalisht. Me të dëgjume e kam që e thojnë që kanë qenë  
2 edhe si diviste e këto. Dhe shumë normale, se në luftë  
3 çlirimtare kërrkush kërrkujna s'mund me ja ndalu pjesëmarrjen  
4 për me çliru vendin e vet. Por unë, si individ, me njerëz të  
5 tillë nuk kam dëshirë dhe nuk do kisha dasht të shoqërohem.  
6 Py. Faleminderit, zoti Veseli. E qartë. Një pyetje të fundit  
7 lidhur me këtë personin të cilin ju sapo e përmendët.

8 A ishin ata të pranishëm në Zllash në këtë kohë,  
9 domethënë, rreth periudhës së prillit ose në prill të vitit  
10 1999?

11 Pë. Nuk e di. Ata kanë qenë se s'i kam njof si individë, por  
12 një e di. Kur ka fillu ofensiva, na kemi krye kryesisht  
13 veprime mbrojtëse se shumë normale nëse zhvillon veprime  
14 luftarake në prezencën e popullit je kriminel se po e vret  
15 popullin tënd.

16 E di që kanë marrë pjesë edhe njësitë BIA në Viti të  
17 Marevcit a pozicionu dhe ka luftu kundra forcave serbe. E kush  
18 kanë qenë me emër, nuk e di. Kam njof Saliun, këtë s'e mohoj.  
19 Kam njofë Salinë edhe para lufta si ish të burgosur politik.  
20 Kam pasë raporte para lufte me të të mira. E konsideroj  
21 bashkëluftëtar. Kemi qenë në një ushtri me të, a kupton, por  
22 për të tjerët nuk muj me thënë ata që s'i njohë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
24 Veseli, të lutem përgjigjuni pyetjeve që ju bëhen dhe mos e  
25 shtjelloni më tej në qoftë se nuk ju kërkohet një gjë e tillë.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 Py. Zoti Veseli, në faqen 15 të transkriptit që kemi përpara  
3 rreshtat 14 deri në 15, juve ju pyetën, domethënë, përpara ju  
4 pyetën për Tabutin dhe këta personat e tjerë. Prokurori vijon  
5 më tej dhe thotë:

6 "A ishin në Zllash këta persona?"

7 Ju thoni:

8 "Po, vinin herë pas here. Ata vinin për t'u strehuar herë  
9 pas here".

10 A të kujtohet tani që këta persona kanë qenë të pranishëm në  
11 Zllash?

12 Pë. Ju lutem, çdo njësi ushtarake kur të vjen, i vjen me ata  
13 që i ka pjesëtarë. Dhe normalisht, po që kanë pjesëtarë kanë  
14 ardhë dhe ata, po unë nuk i njoh.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dhe një  
16 pjesë të fundit. Nuk e di në qoftë se mund të kalojmë tek  
17 faqja 12. Fundi i faqes 12 dhe fillimi i faqes 13.

18 Py. Prokurori, ju pyet dhe jemi në rreshtin 20:

19 "Emri Skifteri çfarë do të thotë për ty?"

20 Dhe ju duket se jeni përgjigjur si më poshtë:

21 "Unë, në fakt, i quaj ata sorra sepse skifteri është  
22 tjetër shpend"

23 Pse i quani sorra, në fakt, njësitin BIA ndërkohë që ata  
24 shenjë e tyre dalluese në fakt kanë skifterat?

25 Pë. Po e shpjegoj prapë. Skifteri është një shpend fisnik dhe

1 asnjëherë nuk del i mundur. E skifter nuk mund me qenë dikush  
2 që s'ke pasë armë për me iu kundërvë dhe këtë qenë i humb,  
3 atëherë, veç sorrë ke mujt me qenë.

4 Py. Po pse sorrë, specifikisht, konkretisht të gjitha  
5 shpendët?

6 Pë. Është një shpend që me asnjë të mund t'mundet.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di  
8 në qoftë se mund të kalojmë në faqen 17 të transkriptit dhe të  
9 fillojmë me rreshtin 7 deri në rreshtin 13.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
11 Sekretare, ju lutem vijoni me shfaqjen e dokumentit.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e shoh dokumentin në ekran.

13 Py. Edhe një gjë të fundit lidhur me këtë çështje. Prokurori  
14 ju ka pyetur:

15 "A ishit pro BIA-s?

16 Dhe ju keni thënë.

17 "Jo".

18 Pyetja është:

19 "Po pse jo?"

20 Dhe ti ke thënë:

21 "Nuk më ka kërkuar mendime njeri".

22 Prokurori, vazhdon:

23 "Po, po të pyes unë sot?"

24 Dhe ti je përgjigjur që:

25 "Jo, mua nuk më pëlqejnë ata, sepse është një pjesë e



1 keqe dhe e pisët e historisë”.

2 Çfarë keni dashur të thoni me këtë? A mund t’i shpjegoni

3 Trupit Gjykues se cila është baza për këtë opinion tuajin? pse

4 e mendoni që njësitit BIA ka qenë një pjesë e keqe dhe e pisët

5 e historisë, zoti Veseli?

6 Pë. Po unë e thashë që në fillin atë. Më duket e kam spjegue.

7 Me pseudonimin e Vdekja e Tabuti për mua nuk mund me qenë

8 pjesë e mirë e historisë. Ma gjej në historinë e një populli

9 në botë dikund që marrin luftëtarët e lirisë asi pseudonimesh.

10 Për atë arsye.

11 Py. Zoti Veseli, juve këtu i referoheni njësitit BIA në

12 tërësinë e vet. Nuk është se juve po i drejtoheni një anëtari

13 të caktuar të BIA-s, pra, juve pyetja ju bëhet për BIA-n dhe

14 ju thoni që nuk më pëlqejnë ata sepse është një pjesë e keqe

15 dhe e pisët e historisë”.

16 Pse e konsideroni të gjithë njësitin që ju duket si një

17 pjesë e pisët dhe e keqe e historisë, domethënë, thjesht për

18 shkak të nofkave që ata përdornin?

19 Pë. Nëse ka qenë lapsusi live mund të ndodhë se krejt njësinë

20 a në bllok nuk e akuzoj.

21 Py. Çfarë bënte njësia BIA që ju bënte juve të mendonit që

22 ata ishin një pjesë e keqe e historisë dhe kujtoni që jeni nën

23 betim këtu?

24 Pë. Po, po. Unë të vërtetës nuk iku. Atë që i kam pa e them

25 dhe s’nguroj hiç fare me thënë. Nëse thotë "jam njësi

1 ushtarake" e tan kohën rrinë në mal, s'rri në terrenin e vet  
2 ku ka qenë i përcaktum, për mua, nuk është në rregull.

3 Py. Kur Prokurori ju pyeti, nja dy rreshta pas kësaj që sapo  
4 lexove, se pse e kishit këtë opinion mbi njësitin BIA, ju nuk  
5 thatë atë çfarë thatë tani, por, në fakt, thanë që në qoftë se  
6 ka krejt kriminelë apo ke hajna në mes veti atëherë i takon,  
7 domethënë, që njësiti i keq. Domethënë, i takon që opinionin  
8 jua j për njësitin BIA mbështetëj në personat që ishin anëtarë  
9 të njësitit BIA; a nuk është kështu?

10 Pë. Unë s'muj me thanë për shembull për njerëz që i njoh. Por  
11 e thashë në fillim, por, nëse ka qysh është fol që ka njerëz  
12 që janë recidivista e këto, për mue, ndryshe s'muj me  
13 vlerësue. Por e di që një e drejtë elementare e njërit është,  
14 pa marrë parasysh kush është, s'un ja ndalon kërrkush  
15 kërrkujna me luftu për çlirimin e vendit të vet.

16 Py. E kuptoj, zoti Veseli. Por, ju lutem, ju keni shprehur  
17 një opinion që, në fakt, është shumë i fortë, i shprehur me  
18 fjalë shumë të forta. Ju e keni dhënë vullnetarisht këtë  
19 opinion.

20 Pë Po.

21 Py. Çfarë kanë bërë ata? Çfarë informacioni keni juve që ju  
22 bëri juve që të shpreheshit që njësiti BIA ishte i tillë?

23 Pë. Thashë çfarë në ato çka u fol.

24 Py. Po çfarë kanë -- çfarë është fol? Ça kanë thënë njerëzit?

25 Pë. Po ç'kanë fol? Këto që ju thashë. Unë kam ardhë me vonesë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sejdi Veseli (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 27  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kam ardhë edhe nuk i kam njohë unë i kam hasë të forum.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të  
3 kalojmë shkurtimisht në seancë private, ju lutem, në mënyrë që  
4 të mund të diskutojmë ca informacion i cili do ishte mirë të  
5 trajtohej në seancë private?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull.

8 Zonja Sekretare, a mund të na kaloni në seancë private,  
9 ju lutem.

10 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 tani jemi në seancë private.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit, zonja Sekretare.

15 Zoti Prokuror, është diçka që doni, dëshironi me  
16 Gjykatën, domethënë, me Gjykatësit apo me dëshmitarin.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua që t'i bëj pyetje zotit  
18 Veseli në seancë të mbyllur.

19 Py. Zoti Veseli, a njeh një person që quhet [REDAKTUAR]

20 Pë. Po.

21 Py. A e ke njohur në atë kohë, në 1999, nga marsi-prilli  
22 1999, në kohën që ti shkove në zonën e Gollakut?

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 Py. A jeni në dijeni që atij i ka ndodhur ndonjë gjë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sejdi Veseli (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje nga z. De Minicis

Faqe 28

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 periudhën e prillit të vitit 1999?

2 Pë. Jo.

3 Py. Jeni i sigurt?

4 Pë. I sigurt.

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 Pë. Nuk më kujtohet.

9 Py. Pra, nuk të kujtohet?

10 Pë. S'më kujtohet.

11 Py. Po nuk është se e përjashton këtë si mundësi apo jo?

12 Pë. E përjashtoj se s'më kujtohet. Se po të kishte qenë diçka  
13 ndonjë bisedë me rëndësi me siguri mu kish kujtu.

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] Zoti Veseli, ju jeni nën betim dhe jemi në seancë  
17 private, kështu që ju lutem përpiquni që të kujtoni?

18 Pë. Ju lutem, nën betim jam po nuk jam nën betim me rrejtë.

19 Gënjeshtër prej meje nuk ka. Nuk mund me thënë ato që çka

20 s'është. Edhe pa marrë parasysh çfarëdo dënimi me më dhënë

21 kurrkush s'ka lind dikush mbi tokë që mua më shtin me thënë

22 atë çka s'e mendoj.

23 Py. Në fakt, ju keni dëgjuar nga të tjerët lidhur me gjërat

24 që kishin ndodhur, që ju bënë juve që të mendoni që ky ishte

25 një pjesë e keqe e historisë. Ju lutem, mundohuni që ta mbani

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sejdi Veseli (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 29  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 mend. Ne nuk duam që të thuash gjëra të gënjeshtërtë por duam  
2 që ti ta kujtosh.

3 Pë. S'më kujtohet. [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR] Ato më kujtohen. E gjatë luftës nuk më  
5 kujtohet.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të  
7 kalojmë sërish në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit.

10 Zonja Sekretare, a mund të na ktheni në seancë publike  
11 përsëri ju lutem.

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
16 lutem mund të vazhdoni, zoti Prokuror.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
18 pyetje të tjera për këtë dëshmitar. Mbaruam me pyetjen për të.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Faleminderit, zoti Prokuror. Shumë mirë

21 Avokatja e Viktimave, a keni pyetje për dëshmitarin dhe a  
22 jeni në gjendje që pyetjet t'ia bëni tani?

23 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
24 pyetje për dëshmitarin.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

1 mirë.

2 Avokati i Mbrojtjes, a keni pyetje për dëshmitarin edhe a  
3 mund të fillojmë tani me pyetjet për dëshmitarin?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Të nderuar Gjykatës, mund të  
5 fillojmë që tani. Por dua që në një pikë të caktuar kohe të  
6 bëjmë një pushim dhe të bëj një diskutim me klientin tim. Nuk  
7 është e nevojshme në këtë pikë, po ndoshta nga pushimi i  
8 drekës ose gjatë ditës sot, do të doja që të komunikoj pak me  
9 klientin tim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
11 mirë, Avokat i Mbrojtjes. Atëherë, fjala është për ju.

12 Mikrofonin, ju lutem.

13 Pyetje të palës tjetër nga zoti Von Bone:

14 Py. Zoti Veseli, dëshiroj që të cekim një serë temash. A  
15 kishte ndonjë arsye të veçantë pse Brigada 153 ndodhej në  
16 Zllash?

17 Pë. Ishte një terren i pambuluar dhe natyrisht që ishte numri  
18 një i madh i popullit i strehum aty. Ma kryesorja a kanë  
19 konfiguracioni i terrenit e mundësonte luftimin sipas  
20 doktrinës së artit të luftës popullore të shkallës dytë.

21 Py. Po, ju kuptoj. A ju kujtohet kur ndodhi bombardimi i  
22 NATO-s në Prishtinë?

23 Pë. Po.

24 Py. Kur ka qenë?

25 Pë. Nga fundi marsit.

1 Py. Nga fundi i marsit, a pati --

2 Pë. Saktë data s'më kujtohet. S'më kujtohet data saktë.

3 Py. Po pavarësisht kurdo që ka ndodhur nga fundi i marsit, a  
4 pati një prurje të madhe njerëzish që kërkonin që të  
5 strehoheshin në zonën e Gollakut?

6 Pë. Para bombardimeve ka pasur prurje shumë të mëdhaja të  
7 popullatës, po sidomos mbas bombardimeve ka pasur prurje shumë  
8 të madhe.

9 Py. Edhe në Zllash besoj, apo jo?

10 Pë. S'ka pasur pjesë e Gollakut që s'ka qenë mbushun me  
11 civilë të ardhur popullatë krejt të shpërngulur.

12 Py. Ku vendoseshin a ku strehoheshin këta njerëz?

13 Pë. Janë vendos nëpër shtëpiat e banorëve, nëpër shkolla.  
14 Kështu që ka pasur edhe me çadra.

15 Py. A kishte ndonjë mënyrë, a ku di unë, aso kohe a ishte  
16 dikush të cilit i ishte ngarkuar detyra që t'i shpërndante  
17 këta njerëz apo këta njerëz shkonin ku t'u jepej, ku të  
18 shihnin për të kërkuar strehim?

19 Pë. Ka qenë mbrojtja civile.

20 Py. Kush ishte në krye të mbrojtjes civile?

21 Pë. Fatmir Sopi.

22 Py. Thatë se jeni marrë vetë me rregulloret e brigadës --

23 Pë. Po.

24 Py. -- për krijimin e rregulloreve të brigadës; kështu?

25 Pë. Po.

1 Py. Çfarë lloj rregulloresh ishin këto?

2 Pë. Rregullore për organizimin e brendshëm të brigadës. Jam  
3 shërbuer me literaturën e ushtrisë shqiptare dhe ushtrisë  
4 jugosllave.

5 Py. Mund të na jepni nja dy shembuj të këtyre rregulloreve?

6 Pë. Rregullorja për mbrojtjen nga mjetet shpërthyes.

7 Rregullorja qysh duhet me u sjellë me popullatën. Rregullorja  
8 e rreshtimit. Rregullorja e raportimit. Rregullorja qysh duhet  
9 me u sjellë me robt e luftës. Edhe ato në përputhje me ligjet  
10 ndërkombëtare për luftën.

11 Py. A kishte ndonjë rregullore sa i takon disiplinës së  
12 brendshme --

13 Pë. Po.

14 Py. -- të anëtarëve të brigadës?

15 Pë. Po.

16 Py. Mund të na jepni një përshkrim të shkurtër se ç'ishin  
17 këto rregulla?

18 Pë. Së pari ka qenë e shkruar Rregullorja e Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovës, globale, kurse ne kemi nxjerrë nga ajo  
20 ç'a na ka taku neve si njësi varëse e Ushtrisë Çlirimtare të  
21 Kosovës. Për shembull, moszbatimi i detyrës prekomandohet një  
22 pjesë tjetër. A kupton. Bisedohet me të, këshillohet me ta, jo  
23 me të tjera metoda. A kupton. Dënim tjetër s'ka pasë.

24 Py. A kishte polici ushtarake, njësit të policisë ushtarake  
25 në Zllash, në zonën e Zllashit?



1 Pë. Ka qenë.

2 Py. Apo në zonën e Gollakut?

3 Pë. Po.

4 Py. Në të njëjtën zonë, me një fjalë, ku ushtronte veprimtari

5 Brigada 153?

6 Pë. Po.

7 Py. Kush ishte në krye të kësaj njësie?

8 Pë. Shukri Rafuna ka qenë.

9 Py. Ju kujtohet zëvendës kë kishte?

10 Pë. Nuk po më kujtohet.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

12 Avokat i Mbrojtjes, pyetja juaj nuk u përkthye. Dhe ishte

13 pyetja ku emri ishte Shukri Rafuna. Pra, pyetja ishte kush

14 ishte në krye të Brigadës 153, këtë deshët të bënit?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, kush ishte në krye të

16 policisë ushtarake.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

18 lutem, përsërite dhe njëherë pyetjen që të jemi të qartë për

19 procesverbalin.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]

21 Py. Shukri Rafuna, ky ishte në krye të policisë ushtarake e

22 kuptova qartë?

23 Pë. Po.

24 Py. A mund të na thoni se ç'kompenca kishte policia

25 ushtarake?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sejdi Veseli (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 34  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Mbrojtja e llogoreve ku janë strehuar banorët, mbrojtja e  
2 njësave, shtabeve. Tjetër detyrë s'ka pasë. Dhe kanë qenë 20  
3 vetë s'ka pasë -- s'ka qenë -- emnin e ka pasë polici  
4 ushtarake. S'kanë qenë as 20 vetë në krejt Gollakun.  
5 Py. Në rregull.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkohet, të nderuarve Gjykatës,  
7 të kalojmë në seancë private.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
9 Sekretare, të kalojnë në seancë private, ju lutem.

10 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 jemi në seancë private.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit. Cila është arsyeja pse kaluam në seancë private?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshiroj që të përmend disa emra.  
16 Dhe është më mirë që këtë ta bëjmë në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
18 të vazhdoni.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Zoti Veseli, a mund të na thoni nëse kishte zëvendës zoti  
21 Rafuna?

22 Pë. Nuk e di.

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR] Kanë qenë njësi luftarake. Njësi të

13 vogla e përndryshe janë kriju mbasi që kanë hy NATO.

14 Py. Zoti Veseli, a e njihni një person me emrin Agron

15 Xhemajli?

16 Pë. Po.

17 Py. Mund të na thoni se çfarë ishte?

18 Pë. Unë Agronin e njoh para lufte. Ka qenë një veprimtar i

19 çështjes kombëtare, qysh në rini s'a kursye kurrë. Natyrisht e

20 kam pasë bashkëluftëtar. Ka qenë bashkëluftëtar i imi. Ne kemi

21 qenë pjesëtarë të një ushtrie. Nuk di diçka keq për të.

22 Py. Ishte anëtar i Brigadës 153?

23 Pë. Jo. Jo. Ai ka qenë, më fal, ka qenë drejt për së drejti i

24 lidhun me zonën, një lloj shërbimi informativ. Gjeneza e

25 shërbimit informativ kanë qenë. Ai neve nuk na ka raportue,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sejdi Veseli (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Faqe 36

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 prej natyrës që ka pasë, as brigadës nuk i ka raportu. I ka  
2 raportu zonës.

3 Py. Për të qenë i qartë, ku ishte e vendosur zona, për cilën  
4 zonë kur thoni zona?

5 Pë. Zona operative e Llapit ka qenë e vendosur në Llapashticë  
6 të Epërme.

7 Py. Faleminderit shumë.

8 Py. A e keni dëgjuar ndonjëherë emrin [REDAKTUAR]? Një  
9 person me emrin [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

11 DËSHMITARI: Zona e përgjegjësisë të Brigadës 153.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Dëshiroj të di nga ana gjeografike - kur thoni "zona e  
14 Zllashit"?

15 DËSHMITARI: Zona e përgjegjësisë të Brigadës 153.

16 Ushtarakisht kështu quhet. Por, po ju them edhe në aspektin e  
17 konfiguracionit të terrenit. E kap Rimanishtë, Bardhosh,

18 Radashevc, Koliq, Grashticë, Mramor, Makovc, Viti e Marevcit,

19 Prapashtice, Kecekollë, Nishevc, Ballaban. Që këto kanë qenë

20 fshatrat të cilat kanë qenë të atakum, kanë qenë zona e

21 përgjegjësisë së Brigadës 153. Këto janë bombardu nga pesë

22 drejtime nga ushtria serbe edhe popullata ka fillu të

23 tërhiqet. Edhe ju lutem ekselencit du me më kuptu drejtë se

24 këto janë emocione, se më kujtohen tash - kur përmenden këto

25 më kujtohen - se nuk është lehtë me pa njerin,

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 71

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 bashkëluftëtarin tënd pre me motosharrë këmbë e duar para  
2 fëmijëve, nuk është lehtë me pa. I kemi pa këto sende. Na kemi  
3 përjetu shumë sende. E kështu mund me ndodhë që kemi nga pak  
4 emocione, po besoj, ju njerëz jeni më kuptoni drejtë, a  
5 kupton. Këtu ndoshta mund me u zgjat ndonjëherë kur po thoni  
6 që po e zgjat, po nuk mund se shpirti flet në ksi momente. Ju  
7 jeni sigurisht shumica prind. Mundni me paramendu qysh e ka  
8 ndie fëmija e tijna - para fëmijëve e kanë pre me motosharrë -  
9 një herë njanën këmbë, tani tjetrën këmbë, tani njëerën dorë,  
10 tani e kanë pre në fyt. Është përmendorja në Makovc. Rreth  
11 120-130 vetë që janë pre aty, kur mbas bombardimit kur ka  
12 fillu me u tërhjek me lyp shpëtim populli me shku drejt  
13 Shqipërisë apo me u tërhjek apo drejt Maqedonisë. Veç mos  
14 harroni se ka pasë paramilitarë, paramilitarë edhe rus edhe  
15 ukrainas.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
17 Veseli. Zoti Veseli do t'ju ndërpres. Do t'ju ndërpres dhe  
18 t'ju bëj, t'ju kërkoj që t'i përgjigjeni pyetjeve.

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
21 t'i kthehem pyetjes time. Nëse thoni "zona e Zllashit" atëherë  
22 unë e kuptoj që me "zonën e Zllashit" ju nënkuptoni zonën e  
23 përgjegjësisë së Brigadës 153. Pra kjo është e njëjtë për ju.

24 Ajo që duam që të shmangim është një keqkuptim kur flasim  
25 për Zllashin, sepse ne kuptojmë fshatin Zllash. Pra kur

1 Avokati i Mbrojtjes jua bëri pyetjen nëse kishte apo jo  
2 refugjatë në zonën e Zllashit, ju e kishit fjalën për zonën  
3 mbi të cilën kishte përgjegjësi Brigada 153, jo se e kishit  
4 fjalën për fshatin Zllash?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull. Këtë desha të sqaroja, sepse kur e ndërpreva Avokatin  
8 e Mbrojtjes për këtë keqkuptim kishte të bënte pyetja ime.

9 Zoti Avokat, keni fjalën.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. Zoti Veseli, a kishte refugjatë edhe në fshatin Zllash?

12 Pë. Po.

13 Py. A mund të na thoni përafërsisht, përafërsisht sa ishin?

14 Pë. Po s'i kemi numëru, po s'ka pasë shtëpi që s'i ka pasë  
15 10-15-20 vetë mrena.

16 Py. E kuptoj. Pra kjo përfshinte edhe zonën rreth shkollës  
17 apo jo?

18 Pë. Në shkollë s'ka pasë se mbasi ishte çështje ushtarake,  
19 ishin ushtarët aty, por shtëpiat përreth, ka qenë çdo shtëpi  
20 minimum 10-15 vetë i ka pasë mrena që janë strehu edhe janë  
21 ushqy me q'ato ça kanë pasë ata.

22 Py. Faleminderit shumë. Zoti Veseli, kur ofensiva iu afrua  
23 fshatit Zllash, ku patët mundësi të shkonit, ku shkuat?

24 Pë. Në mal. Nëpër male. Konfiguracioni i terrenit është i  
25 tillë që mujt me gjetë pozicione. Jemi ripozicionu.



1 Pë. Po refugjatët ku shkuan?

2 Pë. Refugjatët në momentin kur ka fillu granatimi kanë fillu  
3 me u tërhjek. Sigurisht e kuptoni në asi rasti fillon paniku,  
4 s'jena ndal kurrkush, s'e pytin kurrkënd. Turma niset s'muj me  
5 e ndalë kurrkush dhe janë nisë. Është e vërtetë që tan kohën  
6 kemi apelu o mos shkoni në atë drejtim. Po megjithatë i ka  
7 kapur paniku dhe kanë lypë shpëtim.

8 Py. A e dini se pas ofensivës kur u kthyet në fshatin  
9 Zllash?

10 Pë. Na se kemi lëshu fshatin Zllash kurrë.

11 Py. Po unë kujtova sikur ju thatë që shkuat në bjeshkë?

12 Pë. Tjetër është qendra, po fshati ka dhe mal. Po zinin  
13 pozicione të tjera. Na terrenin se kemi lëshu kurrë.

14 Py. A ju desh që të braktisej shkolla?

15 Pë. Po shkolla u granatue kur ka fillu granatimi. Shkolla u  
16 granatue, shkolla ka qenë e papërdorshme. Por ne nuk jemi  
17 tërhjek, bile-bile është e vërtetë na kemi djegë edhe  
18 autobllinda të tyre, kemi goditë edhe autobllinda të tyre edhe  
19 tankset e tyre i kemi goditë.

20 Py. Si ishte situata sa u takon shtëpive në fshatin Zllash  
21 pastaj ofensivës serbe?

22 Pë. Janë djegë shumica e shtëpive të qendrës së Zllashit, t'u  
23 u nisë prej shtëpisë së Fatmirit, mixhës të tijna, shtabi i  
24 fundit ku ka qenë - i thojnë tek Kulecët një vend, ku ka qenë  
25 shtabi i brigadës - është djeg komplet shtëpia, është djeg

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 74

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 edhe kompjuteri që kemi pasë, janë djeg çdo gjë që ka pasë e  
2 kanë djegë. Se ju lutem kanë përdor armatim. Edhe napalm kanë  
3 përdorë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
5 Avokat, më lejoni të bëj një pyetje lidhur me përgjigjen e  
6 dëshmitarit.

7 Zoti Veseli, ju thatë se shumica e fshatarëve në qendër  
8 të Zllashit u dogjën, e keni fjalën për shtëpitë e fshatarëve?

9 DËSHMITARI: Shtëpitë, shtëpitë, po edhe shkollat. Shkolla  
10 u goditë me granatë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Faleminderit.

13 Zoti Avokat i Mbrojtjes, mund të vazhdoni.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. Në ç'moment mbaroi pra ofensiva në fshatin Zllash? Ju  
16 kujtohet?

17 Pë. Po.

18 Py. Mund të na e thoni përafërsisht?

19 Pë. S'ka zgjat, një javë ditë. Një javë ditë. Për një javë  
20 ditë ka mbaru. E kanë kry punën e vet. Janë tërhjek. Janë  
21 pozicionu prapë në pozicionet e mëparshme, e kanë mbajt në  
22 rrethim.

23 Py. Pati shumë vdekje asokohe?

24 Pë. Ka pasë. Po.

25 Py. Në fshatin Zllash?

1 Pë. Po.

2 Py. Këta ishin të dukshëm? Të vdekurit them.

3 Pë. Civilë, fëmijë, gra ka pasë që janë vra.

4 Py. A e dini se çfarë u ndodhte? Ç'bëhej me këta njerëz që  
5 ishin të vdekur aty?

6 Pë. Ata kanë praktikë - ka punu thika në fyt, çarja e  
7 gjoksit, bile, bile edhe lopët i kanë vra. Edhe ato i kanë  
8 pengu. Edhe lopët që kanë qenë t'u u kullot i kanë vra.  
9 Automobilat kush i ka pasë i kanë shkel me tankse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
11 Veseli, ju lutem a mund t'i përgjigjeni pyetjes. Ose ndoshta e  
12 keni keqkuptuar pyetjen. Pra Avokati tha që çfarë ndodhte me  
13 personat që ishin të vdekur dhe të shtrirë përdhe.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. D.m.th. çfarë ndodhte me trupat e personave të tillë  
16 eventualisht?

17 Pë. I kemi varros ne.

18 Py. Ku?

19 Pë. Në varrezat e fshatit.

20 Py. Kur ka ndodhur kjo në kohë?

21 Pë. Mbas ofensivës. Kur janë varros është përmendore sot.  
22 Është një lloj lapidari ku shkojnë njerëzit. Në përvjetore  
23 shkojnë aty tek Vitija e Marevcit. Dhe Vitija e Marevcit  
24 kufizohet me Zllashin.

25 Py. A jeni ju në dijeni nëse ka pasur persona të

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 76

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 paidentifikuar?

2 Pë. Persona të paidentifikum kanë mujt me qenë ata që janë

3 djeg në shpi, ma konkretisht po them me emër, baba i një

4 bashkëluftëtari të tonë, Shefki Gashi me gjithë djalin janë

5 djegë në shtëpi. Atje janë gjetë vetëm eshtnat. Ata mujt me

6 qenë ta paidentifikum, a kupton.

7 Py. A ka pasur njerëz që ishin në një vend konkret që nuk

8 ishin të identifikuar dhe pastaj janë identifikuar më pas?

9 Brenda brigadës ose më vonë a është bërë ndonjë identifikim

10 prej tyre ose a ka pasur një njësi, detyra e të cilit ka qenë

11 që të gjenin personat, identifikimin e personave të cilët nuk

12 i mbijetuar ofensivës?

13 Pë. Pas luftës, Instituti i Forensikës këto i ka bo,

14 menjëherë pastaj hyrjes së NATO-s.

15 Py. Për çfarë periudhe flasim, për çfarë periudhe kohe po

16 flasim?

17 Pë. S'ka zgjat shumë se më 12 qershor veç përfundon, vijnë

18 forcat e NATO-s tokësore, zbarkojnë. Dhe atëherë faktikisht

19 lufta përfundoi.

20 Py. Ku qëndronte në atë kohë familja juaj?

21 Pë. Familja ime kanë ikë me refugjatë bashkë i kanë përzënë.

22 Nga Prishtina kanë shkuar për Shqipëri.

23 Py. E kuptoj.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Vetëm një çast të nderuar

25 Gjykatës.

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 77

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Kemi pyetjet përmbyllëse dhe  
5 pastaj përfundojmë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa  
7 kohë mendoni se keni, se ju duhet?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Për pak minuta.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e  
10 them këtë gjë sepse dua që të përfundojmë rreth orës 13.15 në  
11 mënyrë të tillë që t'ju lejojmë njerëzve që të hanë drekë. Dhe  
12 sigurisht që kemi kohë edhe pas këtij orari. Po thjesht për të  
13 ditur dhe për t'ju treguar juve se çfarë kisha në mendja kur  
14 jua bëra këtë pyetje.

15 Z. VON BONE: [Përkthim]

16 Py. Kush është Shukri Rafuna, zoti dëshmitar?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që  
18 e kemi diskutuar këtë çështje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam  
20 dakord me Prokurorin.

21 Ju lutem hartoni ose formuloni pyetjen tuaj pasuese.

22 Z. VON BONE: [Përkthim]

23 Py. A e dini ju se kur është bërë komandant ky person?

24 Pë. Para ofensivës. Brigada ka qenë në themelim e sipër. Për  
25 çdo ditë janë vu komanda, janë kry njësia e re, normalisht u

1 bo komanda. Mirëpo emrin në polici e ka pasë - po s'ka qenë në  
2 polici, fakti ka qenë një lloj sigurimi, sikur sigurimi që i  
3 bëhet objekteve. Ka sigurue familjet ku janë vendosë nëpër  
4 shkollë mos me i ndodhë diçka, ka sigurue shtabet e njësive,  
5 tjetër punë s'ka pasë.

6 Py. A keni pasur ndonjë kontakt specifik me Shukri Rafunën?

7 Pë. Po, e njoh atë. E kam njoh edhe para lufte.

8 Py. Në periudhën gjatë luftës, në periudhën, në prill të  
9 vitit 1999, a merrte pjesë ai në takime të komandës të  
10 Brigadës?

11 Pë. Jo.

12 Py. Pse?

13 Pë. Nuk e di. Duhet me pyt Adem Shehun.

14 Py. Në fund, juve në një pikë të caktuar kohe u bëtë shef  
15 shtabi, e saktë kjo?

16 Pë. Po.

17 Py. Kur ka ndodhur kjo?

18 Pë. Pas tërhekjes të plagosurve nga Prapashtica në Koliq.

19 Py. Cila ishte arsyeja për këtë?

20 Pë. Se ishin në vijë të frontit edhe duheshin me i tërhjekë.

21 Edhe masanejna arsyeja duhet me këqyr në komandën e zonës,

22 s'di unë. M'kanë thonë ma mirë ti mund e kryen këtë. Kanë pasë

23 njohuri që - e kanë ditë që kam njohuri ushtarake edhe ma kanë

24 dhanë atë detyrë. Unë nuk kam ardhë në luftë - s'kam shku në

25 luftë për poste. Edhe tash po e them edhe këtu shumë shkurt -

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 79

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 në q'atë moment kur kanë thonë "hiqni armët se ka hy NATO",  
2 unë kam lyp demobilizim, jam kthyer në vendin e punës time mbas  
3 16 vjet e 6 muaj ditë në Institutin Kombëtar të Shëndetit  
4 Publik.

5 Pë. Në rregull.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
7 pyetje të tjera.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit zoti Avokat.

10 Tani do të bëjmë pushimin e drekës deri në orën 3 pa një  
11 çerek. Shpresoj të mund të pushoni z. Veseli, të hani dhe  
12 drekën dhe pastaj do të vazhdojmë në orarin që thashë më  
13 sipër.

14 DËSHMITARI: Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Tani do t'i  
16 kërkoj Sekretares që t'ju shoqërojë dhe të dilni nga salla e  
17 gjyqit.

18 Faleminderit për tani.

19 DËSHMITARI: Faleminderit.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit zonja Sekretare.

23 Pra do të kemi mundësinë që të bëjmë pyetje plotësuese.

24 Z. Prokuror, mendoni se keni nevojë për pyetje plotësuese?

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, por

1 nuk është se kemi shumë pyetje. Parashikoj 15 deri në 20  
2 minuta maksimumi.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Avokate e Viktimave do të bëni pyetje?

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mbase jo, por gjithsesi do të bëjmë  
6 një rishikim të materialit gjatë pushimit edhe n.q.s. kemi  
7 pyetje do jetë maksimumi një ose dy pyetje.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
9 për momentin nuk do ju bëj pyetje juve lidhur me pyetjet  
10 plotësuese, Avokat i Mbrojtjes.

11 Për procesverbal kam diçka që dua të përmend sa i takon  
12 komunikimit të ZPS-së dje. Dje në orën 09.48 na është dërguar  
13 një email në adresat tona sa i takon vlerësimit për kohën e  
14 marrjes në pyetje për këtë dëshmitar. Thjesht doja që t'ja u  
15 bëja me dije.

16 Faleminderit për këtë.

17 Mirë atëherë. Tani do të fillojmë siç e thashë dhe më  
18 parë. Do rifillojmë seancën në orën 3 pa një çerek.

19 Përfundohet seanca këtu.

20 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.10

21 --- Seanca rifillon në orën 14.45

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
23 mirë. Mirë se u kthyet sërish. Të shohim kush janë të  
24 pranishëm. Zoti Prokuror?

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi të



1 njëjtët siç ishim më parë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit zoti Prokuror.

4 Avokatja e viktimave, fjala për ju.

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Avokatja e Viktimave?

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita. Nuk kemi ndryshime.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

11 mirë.

12 Z. Von Bone?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] As ne nuk kemi ndryshime.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Shikoj që zoti Mustafa është i pranishëm përmes videolidhjes.

16 Zonja Sekretare, a mund të sillni dëshmitarin në sallë ju

17 lutem.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

20 se erdhët.

21 DËSHMITARI: Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

23 do të vazhdojmë me pyetjet plotësuese nga Prokurori.

24 Fjala për juve, Prokuror.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar

1 Gjykatës.

2 Pyetje vijuese nga z. De Minicis:

3 Py. Z. Veseli, kam disa pyetje plotësuese për ju.

4 Pyetja e parë ka të bëjë me një urdhër që është  
5 nënshkruar prej jush dhe që diskutuat me Mbrojtjen, me palën  
6 tjetër. Urdhri është dokumenti i cili identifikohet me numër  
7 identifikimi U000-9804 dhe diskutimi ka të bëjë me faqen 33 të  
8 transkriptit të përkohshëm për sot.

9 Ndërkohë, në faqen 35, juve shpjegoni që ky ishte një  
10 urdhër për të arrestuar një operativ në zonën e Karadakut që  
11 kishte vjedhur miell, i cili kishte si destinacion fundor  
12 njerëzit, pra duhej përdorur nga njerëzit. Ndërkohë që kur u  
13 pyetët nga Mbrojtja në qoftë se ishte zakon që një urdhër të  
14 tillë ta shkruanit, ta bënit me shkrim, juve u përgjigjët që,  
15 ju mendonit që ishte mirë që urdhri të jepej me shkrim, sepse  
16 fjalët i merr era. A e mbani mend këtë?

17 Pë. Po.

18 Py. Pra, e kuptoj se çfarë mendimi keni ju lidhur me këtë.  
19 Por, a jeni në gjendje të thoni se, të gjithë urdhrat e  
20 arrestimit që janë nxjerrë nga komandantët e UÇK-së gjatë asaj  
21 kohe në vitin 1999, të gjitha janë bërë me shkrim?

22 Pë. Nuk di çfarë kanë ba të tjerët, por unë e kam ba me  
23 shkrim. Ka qenë i vetmi kjo. Jo që e kam ba atëherë, por  
24 çdoherë do ta bëja një gjë të tillë.

25 Py. Faleminderit. Pyetja e dytë është si më poshtë. Është një

1 pyetje që ka të bëjë me zotin Rrahman Dini. Ne diskutuam  
2 lidhur me të sot dhe në faqen 11 të transkriptit në kohë  
3 reale, ju u pyetët nga Paneli në qoftë se ai -- si ishte  
4 gjendja shëndetësore. Dhe ju thatë që, gjendja shëndetësore  
5 ishte e keqe. Në faqen 46 pas pyetjes që ju bëri Gjykatësja,  
6 ju thatë që në fakt ai priste dhe të vdiste.

7 Tani, Rrahman Dini ishte shok i juaji, në atë kohë. A ke  
8 pasur mundësi që ta vizitosh ti atë në mars apo prill të vitit  
9 1999?

10 Pë. Atë e kam parë përditë. Për çdo ditë e kam parë.

11 Py. Dhe në cilën zonë rikuperohej në Zllash? Mund të na thoni  
12 ju lutem, se ku qëndronte ai ndërkohë që po e merrte veten, po  
13 rikuperohej?

14 Pë. Në një shtëpi vendosur... Përndryshe ai s'e dinte se po  
15 pret vdekjen, por ne e prinim që ka me vdek. Se diheshin  
16 shenjat, ishin shenja të tilla që ai nuk kishte shpëtim, se  
17 ishte i dekompozuar totalisht.

18 Py. Kjo shtëpia, a ishte pjesë e kompleksit në bazën e BIA-s,  
19 apo ishte jashtë?

20 Pë. Jo, jo, jo. Jashtë, jashtë.

21 Py. Jashtë?

22 Pë. Kjo ka qenë afër shkollës. Nuk ka qenë larg shkollës.

23 Py. Zoti Veseli, nuk kam pyetje të tjera për juve.

24 Faleminderit.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi

1 pyetje të tjera për Dëshmitarin.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, znj. Avokate.

4 Tani pala tjetër. Avokati i Mbrojtjes, a doni që të bëni  
5 pyetje plotësuese, z. von Bone?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Kemi  
7 vetëm një pyetje.

8 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Von Bone:

9 Py. [Përkthim] Urdhri që përmendi Prokurori pak çaste më  
10 parë, që keni nxjerrë ju, a ishte praktikë e zakonshme që  
11 urdhra të tillë ju t'i nxirrnit me shkrim, t'i bënit me  
12 shkrim?

13 Pë. Ajo s'ka ndodhur kurrë. Hera e parë ka qenë ajo, që s'do  
14 të thotë që kishte me ndodhë edhe herë tjetër po të kishte pas  
15 raste të tilla. Se tjetër gjë nuk e meritojnë ata që vjedhin  
16 bukën popullit. Që vjedh jetesën popullit. E, hajni dihet edhe  
17 krimineli ku e kanë vendin. Ashtë dash të ndalohej. Pastaj, ne  
18 si ky ndalim s'kemi pas. Sigurisht kishim me ia dorëzuar zonës  
19 së Llapit.

20 Py. E kuptoj. Por pyetja ishte ndryshe, ishte pjesë e  
21 rregullave tuaja që urdhrat të jepeshin me shkrim?

22 Pë. Jo. Unë e kam ba atë vetë, me kokën time e kam ba  
23 atë. Se, normalisht nuk kam dit tjetër mënyrë, qysh. Por, atë  
24 është dashtë gjithqysh me e ndalu, se ai ka vjedhur bukën  
25 epopullit. Bukën që e kanë dhuruar të tjerët, e kanë dhuruar

1 për me i dhanë bukë popullit, ai e ka vjedh bukën e popullit.

2 Edhe natyrisht e kam ba, kisha me e ba prapë, edhe fare

3 s'pendohem që e kam ba. Po më vjen keq, nuk e di a është

4 ndalu, a nuk ashtë ndalu, nuk e di.

5 Py. Në rregull. Pyetja nuk ishte se çfarë kishte bërë ai

6 personi, por pyetja ka të bëj me faktin në qoftë se urdhra të

7 tillë zakonisht bëheshin me shkrim. Edhe prandaj thashë, a

8 është pak a shumë standard, ishte praktika e zakonshme kjo që,

9 urdhrat të bëheshin me shkrim?

10 Pë. Z. Avokat, në çdo ushtri urdhrat jepen me shkrim. Urdhri

11 është urdhër. Ai protokollohet, është urdhër. Po qe se ka

12 logon e ushtrisë, ai është urdhër me shkrim. Nuk jepen me gojë

13 urdhrat në ushtri. Urdhrat me gojë jepen vetëm në vijë të

14 frontit, në komandë kur komandon ushtarët, sulm apo.

15 Përndryshe, të tjerat jepen me shkrim.

16 Py. Në rregull. Shumë faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

18 Avokat, keni përfunduar me pyetjet, apo jo?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

21 mirë.

22 Zoti Dëshmitar, sot ju kanë bërë shumë pyetje Prokurori,

23 Avokati i Mbrojtje, Avokati i Viktimave, ndërkohë që do t'ju

24 kërkoja që të na duronit dhe pak, sepse tani është radha e

25 Gjykatësve për t'ju bërë disa pyetje, në mënyrë që ta kuptojmë

1 pak më qartë e më mirë gjëra të caktuara të cilat juve keni  
2 trajtuar në dëshminë tuaj sot paradite.

3 Pyetje nga Trupi Gjykses:

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne  
5 sot diskutuam për rajonin e Gollakut. A mund ta sqaroni për  
6 Trupin Gjykses ju lutem, se cilat fshatra përmban regjioni i  
7 Gollakut? Jo të gjithë ndoshta, por pjesët kryesore të tyre,  
8 në mënyrë të tillë që neve të kuptojmë pak më mirë se, për  
9 cilën zona, apo për cilën regjion po flasim?

10 Pë. Gollaku është një krahinë e madhe. Dhe kurrë qysh brigada  
11 s'ka mujt me mbulu krejt Gollakun. Ne kemi mbulu fshatrat që i  
12 numëruam në fillim. Por përsëri, nëse është nevoja po i  
13 numëroj. A t'i numëroj fshatrat?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
15 të lutem.

16 Pë. Rimanishtë, Kulinë, Bardhosh, Radoshevc, Grashticë,  
17 Makovc, Mramor, Busi, Zllash, Keçekollë, Koliq, Ballaban,  
18 Nishec edhe Prapashticë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e  
20 kuptoj drejtë që zona e Gollakut është e njëjta me zonën e  
21 Zllashit?

22 Pë. Jo. Gollaku është shumë ma i madh, është.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zona  
24 e Gollakut, është kjo zona që ka qenë nën përgjegjësinë e  
25 Brigadës 153?

1 Pë. Pjesa -- këto që numërova kanë qenë zona e përgjegjësisë  
2 së Brigadës 153.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit. Ne kemi diskutuar sot për kompleksin e BIA-s, në  
5 fshatin Zllash. Sot ju na thatë se ushtarët e njësitit BIA -  
6 dhe kjo thuhet në faqen 44 rreshti 9 të transkriptit në kohë  
7 reale - ju thatë që, ushtarët shkonin në Zllash për të  
8 pushuar.

9 Në dy raste të tjera - dhe dua t'i citoj për procesverbal  
10 dhe kam kërkuar që ato të shfaqen në ekran - ti the se,  
11 kompleksi i BIA-s në Zllash përdorej nga ushtarët e njësitit  
12 BIA si strehim.

13 Dhe për procesverbal po i referohem pjesës së dytë, faqja  
14 13, rreshti 18 deri në 21 dhe po ashtu faqja 16, pjesa e dytë,  
15 rreshtat 24 deri në 25.

16 Pra, keni folur për pushimin dhe për t'u strehuar, për  
17 ushtarët e BIAS-s. Këtë keni cituar ju si arsye se përse  
18 shkonin ushtarët atje. Ju lutem na e shpjegoni pak se çfarë  
19 donit të thoni, kur thoni që, ata shkonin për të pushuar edhe  
20 për t'u rehabilituar, pse duheshin të strehoheshin apo të  
21 rehabilitoheshin?

22 Pë. Sepse me pas shku në Prishtinë ka qenë e pamundur. E  
23 kishin me u mbrojt nga policia e serbëve. Natyrisht e kanë  
24 zgjedh, përndryshe nuk di tjetër arsye çfarë kanë pasur.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por

1 pse konkretisht, pse specifikisht ushtarët e BIA-s dhe jo

2 ushtarët e tjerë të UÇK-së?

3 Pë. Ushtarët e UÇK kanë qenë në Brigadën 153 ka pas terrenin  
4 të mbulum. Por konfiguracioni i terrenit të Gollakut ashtë i  
5 tillë që, më e lehtë ashtë me u mbrojt se në qytet, e se kudo  
6 tjetër. Se ashtë vend kodrinor malor dhe për atë arsye e kanë  
7 zgjedhur një lloj strehimi shumë normale, si bazë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
9 rregull. Por pyetja ime është kjo, pse konkretisht bëhej fjalë  
10 për ushtarët BIA-s që shkonin atje për t'u strehuar. Dhe jo,  
11 për shembull, pse nuk shkonin ushtarët e Brigadës 153?

12 Pë. Se faktikisht ata kanë qenë njësit tjetër. BIA ka qenë  
13 një njësit tjetër. Brigada 153 ka qenë tjetër. BIA nuk i ka  
14 raportu Brigadës 153 dhe s'ka qenë pjesë e Brigadës 153. Ata  
15 kanë qenë njësi në vete.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë  
17 e kam shumë të qartë. Faleminderit për këtë. Por pyetja ime  
18 është ndryshe. Pyetja ime është kjo, pse thua ti konkretisht,  
19 specifikisht që ishin ushtarët e BIA-s që shkonin atje për t'u  
20 strehuar, në Zllash për t'u strehuar?

21 Pë. Nisem nga përvoja ime në kohën e ilegalitetit. Edhe unë  
22 kur kam kryer diçka një aksion në qytet, jam tërhequr diku në  
23 fshat, me u strehu një kohë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
25 mua nuk është krejt e qartë ende.



1           Megjithatë, thatë sot - edhe do ta përmend se ku, është  
2   faqja 22, rreshtat 7 dhe 9 dhe faqja 29, rreshti 18 deri në 21  
3   - thatë që, ushtarët e BIA-s ishin lart në bjeshkë dhe nuk  
4   ishin të kyçur në fushëbetejë. A mund të sqaroni diçka më  
5   shumë se çfarë keni dashur të thoni me këtë?  
6   Pë. Kur ka filluar ofensiva, ushtarët e BIA-s, ata të cilët  
7   kanë qenë atje, janë radhit në një front të përbashkët me  
8   brigadën 153. Se ne faktikisht kemi qenë ushtarë, pjesëtar të  
9   një ushtrie, të gjithë. Ata s'do të thotë që kanë qenë të  
10   huaj, por kanë qenë njësit në vete dhe disiplina ushtarake i  
11   lyp ato secila njësi në vete ka programin e vet, e ka  
12   shtjellimin e vet, i ka veprimet taktike të vetat dhe kështu  
13   që normale ka qenë ajo që të jenë të ndarë. Si çdo ushtri  
14   tjetër.

15           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
16   t'ju lexoj se çfarë keni thënë, zoti Veseli.

17           "Ajo që pashë dhe do ta them dhe nuk hezitoj ta them, se  
18   njëri bën sikur është njësi ushtarake dhe gjithë kohës qëndron  
19   lart në bjeshkë dhe nuk kyçet asnjëherë në fushëbetejë, për  
20   mua kjo nuk është e rregullt".

21           Këtë keni thënë kur ju bë pyetje se, çfarë ka bërë BIA që  
22   ju ta mendoni si një pjesë të keqe, të pisët të historisë. Dhe  
23   këtë përgjigje dhatë. Dhe tani unë ju pyes, a mund të na  
24   shpjegoni se çfarë keni dashur të thoni me këtë? Se unë tashti  
25   po kuptoj që, ata ishin ushtarë të cilët nuk merrnin pjesë

1 nëpër luftime, fshiheshin nëpër bjeshkë.

2 Pë. Unë programin e tyre nuk e kam ditur dhe s'kam dashur me  
3 u interferu në punën e tyre. Ata i kanë ditur punët e veta,  
4 por një e di dhe e kam thanë edhe e them gjithherë, kanë qenë  
5 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe ata kanë pas  
6 programin e vet, kanë pas komandën e vet dhe natyrisht në bazë  
7 të programit të vet kanë ba edhe veprimet taktike që u është  
8 dash me i ba.

9 E thashë më parë që, kur ka ardh puna tek ofensiva, ato  
10 ushtarët e BIA-s të cilët kanë qenë të strehuar në atë  
11 kompleksin, ata janë bashku në një front me brigadën 153 e  
12 kanë luftuar. Edhe ma konkretisht në Tevitia e Marevcit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
14 Veseli, pyetjes sime nuk iu përgjigjët në kuptimin -- se unë  
15 po ju kërkoja sqarim. Ose na thoni diçka më shumë, për faktin  
16 pse nuk ju dukej gjëja e duhur që të qëndronin lartë në  
17 bjeshkë dhe të mos kyçeshin asnjëherë në luftim.

18 Tani unë po përpiqem të shpjegoni, të sqaroni diçka më  
19 shumë se çfarë keni dashur të thoni me këtë. Ndërkohë që ju më  
20 përgjigjeni që, gjatë ofensivës ata kanë luftuar bashkë me ju.  
21 Por nuk iu jeni përgjigj pyetjes sime, nuk ishte kjo pyetja.

22 Pë. Unë kam thënë që vijnë me u strehu. Ata nuk kanë ardh që  
23 të punojnë në bujqësi. Kanë marrë pjesë në luftarake. Edhe unë  
24 nuk bie në kontradiktë me vetveten, unë e kuptoj. Ata kanë  
25 ardh -- mundet të ketë qenë lapsus gjuhësor. A po kupton. Edhe

1 mundet të ndodhë që edhe tek përkthimi, unë e di e kam pa, kur  
2 e kam pa trasnkriptin, kam pa që çfarë gabimesh katastrofave  
3 kanë, çfarë konstrukti i fjalisë pa lidhje ka. Edhe mund të  
4 ndodhë.

5 Unë po them shumë troç këtu jam, po e them shumë troç.  
6 Ata kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,  
7 ashtu sikur kam qenë unë. Ata e kanë pas komandën e vet, s'ka  
8 qenë detyrë e imja me përcjellë çka punojnë ata. Edhe as kam  
9 lejuar as mua me më përcjellë çka punon Brigada 153. Se janë  
10 rregulla ato, shumë strikte. A po ndryshe kurrkush, një njeri  
11 me dy mend, siç thotë populli, nuk mund t'ia mohosh se ata  
12 kanë luftu kundra pushtuesit. Edhe kanë ardh, jo për qejf, nuk  
13 kanë ardh në piknik në Zllash, por kanë ardh me u rehabilitu  
14 pas aksioneve që kanë kryer. Se kanë kryet aksione. Edhe ju  
15 lutem, guerilja e qytetit e ka detyrë shumë të rëndë se duhet  
16 -- shumë vështirë është puna në qytet.

17 Qyteti ka qenë i rrethuar, ka qenë i vëzhgu prej  
18 snajperëve. Numër shumë i madh njerëzish janë vra duke dash me  
19 kalu në Gollak, me u strehu, nga pozicionet e maskuara të  
20 ushtarëve dhe paramilitarëve serb. Ata e kanë vështirë edhe me  
21 kalu me ardh. Por, ka qenë terreni ma i përshtatshëm për  
22 rehabilitim, për pushim pasi që kanë kryer aksionin. Çdo njeri  
23 kur kryen një punë, lyp një pushim pastaj, jo më ushtari.

24 Ju s'kini parasysh, ushqimi si ushqim -- nuk e kemi pas  
25 ushqimin si ushtritë e rregullta. S'e kemi pas logjistikën si

1 ushtritë e rregullta. Ne kemi filluar, e kam thënë në fillim  
2 me --.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
4 rregull. Qartë. Tani do t'ju ndërpres zoti Veseli. Ju garantoj  
5 që për përkthimin kujdesemi në mënyrë shumë të mirë dhe çdo  
6 gjë që ju thoni në shqip, pasqyrohet qartë në versionin në  
7 anglisht.

8 Po e le këtë temë.

9 A mund të na e përshkruani fshatin Zllash? Fshatin  
10 Zllash.

11 Pë. Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
13 të na e përshkruani, ju lutem.

14 Pë. Në Stallovë ndahet rruga drejt Zllashit. Nga rruga e cila  
15 vjen prej Prishtinës deri në Stallovë. Rruga që shkon për në  
16 Keçekollë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
18 jo. Përkthyesit kërkojnë që ta përsërisni nga fillimi i  
19 përgjigjes. Që nga fillimi edhe një herë ta përsërisni.

20 DËSHMITARI: Po. Nga rruga që vjen Prishtinë - Keçekollë  
21 - Prapashticë, shkon për në Medvegje. Ndahet në Stallovë rruga  
22 për në Zllash. Duhet 3-4 kilometra rrugë për të hyrë në  
23 fshatin Zllash. I pari objekt që haset në Zllash, është  
24 shkolla dhe shtëpia e Fatmir Sopit, ku ka qenë. Është një  
25 lagje si çdo fshat tjetër, një lagje me shtëpi afër njëra-

1 tjetrës. Edhe vazhdohet drejt Zllashit të vogël, është një  
2 lartësi mbi detare të caktuar, i thonë Zllashi i Vogël. Nga  
3 ana veriore kalohet del në rrugën që shkon Viti-Slivovë -  
4 Gjilan dhe drejt për Prishtinë. Kjo ashtë Zllashi. Zllashi nuk  
5 ashtë fshat i madh. Zllashi komplet me i marrë, nuk i ka 30  
6 shtëpi. Zllash qendra.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Shtëpitë, që thatë disa prej tyre ishin pranë njëra-tjetrës,  
9 ngjitur me njëra-tjetrën, po a kishte edhe ndonjë distancë  
10 ndërmjet shtëpive -- ta them ndryshe, nga veriu i Zllashit  
11 deri në jug të Zllashit, sa kilometra mund të bëhen gjithsej?  
12 Dhe nga lindja në perëndim?

13 Pë. Nëse ban një rreth, me e mat diametrin, nuk i ka 4  
14 kilometra. Në të dy drejtimet. Në të dy drejtimet, 4  
15 kilometra. Nuk ka ma shumë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
17 në këtë sipërfaqe ndodheshin të 30 shtëpitë?  
18 Py. Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
20 Mramori, sa larg ndodhej nga Zllashi?  
21 Pë. Mramori nga Zllashi i bjen jo -- Mramori është një fshat  
22 i madh. Gati si qytezë. Tre kilometra prej Zllashit, s'ka ma  
23 shumë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra  
25 nuk mund të themi se - ose jo, a mund ta quanim Zllashin si

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 94

Pyetje nga Trupi Gjykues

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 një lagje të Mramorit?

2 Pë. Mundet. Se Mramori dikur ka qenë komunë dhe Zllashi ka

3 qenë pjesë e Mramorit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

5 rregull. Po, kjo e sqaron për ne. Faleminderit zoti Veseli.

6 Kaloj tek pyetja tjetër tani.

7 Zonja Sekretare, ju lutem të nxirrni në ekran nga

8 deklarata e dëshmitarit me numër ERN069889-TR-ET, Pjesa 1,

9 faqja 14, rreshtat nga 5 deri në 11.

10 Këtu flitet për zonën e Gollakut dhe po flisnit për -- e

11 ke fjalën për Gollakun:

12 "Po. Kishte grupe sulmuese që quheshin Buna".

13 Desha t'ju pyes, çfarë keni dashur të thoni me këtë

14 fjalën "njësi sulmuese që quheshin Buna", çfarë njësie kanë

15 qenë këto?

16 Pë. Por që s'kanë pas formacione të rregullta ushtarake. Kanë

17 qenë grupe luftarake nëpër fshatra. Buna është quajtur, emërtu

18 Buna.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

20 mund të na shpjegoni neve, pse kjo zonë ishte zona më pak e

21 organizuar?

22 Pë. Mund të ndodhë që ne kemi qenë në periferi, për shembull

23 kemi qenë në kufi me Serbinë dhe armatimet kanë ardhur e janë

24 ndalur në pjesë të tjera të Kosovës. Edhe kur kanë ardh, pak

25 armatime kanë ardh. Përndryshe ne shumë, shumë djem e vajza

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 95

Pyetje nga Trupi Gjykues

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kemi kthy se s'kemi pas armë me i dhanë. Vetëm për atë, vetëm  
2 për mungesë të armatimit. S'kemi pas armë me i dhanë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur  
4 flisni për këtë njësinë sulmuese Buna, kjo përfshin dhe Buna  
5 29?

6 Pë. Po. Kanë qenë me numra të ndarë Buna. Të gjitha këto  
7 bazat janë quajtur Buna, që është menduar kur të fillojnë  
8 formacion të rregullt ushtarak, me u shndërru në njësi, 2  
9 njësi e nëse ashtë më e madhe me u ba kompani, me shku tek  
10 batalionet, e me u ba brigada, me plot kuptimin e fjalës sipas  
11 standardeve ushtarake për një brigadë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
13 deklaratën e dëshmitarit që ia keni dhënë ZPS-së që është  
14 pjesa 2, faqja 19, me të njëjtën numër që e kam cituar  
15 përpara, keni folur për Buna 26.

16 Pë. Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Pyetja që kam unë edhe ky ka qenë grup sulmues, është quajtur  
19 grup sulmues?

20 Pë. Këto kanë qenë më shumë grupe mbrojtëse. Ne veprimet  
21 sulmuese i kemi ba vetëm kur s'ka pas qytetarë dhe në periferi  
22 të zonës. Përndryshe brenda nuk kemi ba sulme, s'kemi organizu  
23 sulme për shkak të popullatës, e kemi ruajt popullatën.

24 Buna 26, mbasi pyetët, atë e kanë rrafshu me tokë, me  
25 themel e kanë djegë ushtria serbe gjatë ofensivës.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku  
2 ishin të vendosur këto, ku kanë qenë?

3 Pë. Në rrugën Stallovë-Zllash. Në mes të rrugës Stallovë-  
4 Zllash.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
6 ta përsërisni edhe njëherë në rrugën?

7 Pë. Në aksin rrugor ku ndahet prej Stallovës, i thonë Bunari  
8 i Thatë ma konkretisht. Pika ku ndahet rruga, Bunar i Thatë i  
9 thonë, që kthehet rruga për Zllash, ka qenë Buna 26.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
11 kështu sqarohet edhe deklarata që i keni dhënë ZPS-së. Sepse  
12 aty përmendet një Stalloviça.

13 Pë. Stallovë. Veç Stallovë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra  
15 është Stallovë. Në rregull. Mendova se mos kishte ndonjë  
16 problem më përpara.

17 Pë. Ajo quhet veç Stallovë. Dhe t'jua shpjegoj edhe këtë, aty  
18 është një kryq i rrugës, ndan, në anën tjetër ndahet rruga për  
19 në Koliq. Ajo është një kryq i udhës, Stallova

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
21 për t'ju përgjigjur pyetjes sime, unë pyeta ku ndodhej Buna  
22 26, ju thatë përpara fshatit Zllash. Pa shku në Zllash.

23 Pë. Në mes të rrugës, jo bash afër, në mes të rrugës. Ma  
24 shumë i afrohet një lagje Kopran, quhet ajo, për në Stallovë.  
25 Në Stallovë ashtë, në regjionin e Stallovës ka qenë.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa  
2 larg është, çfarë distance nga fshati Zllash?  
3 Pë. Mund të jetë dy kilometra, dy e gjysmë, jo ma shumë. Po  
4 them në vijë ajrore, se konfiguracioni i terrenit, në vijë  
5 ajrore mund të jetë 2 e gjysmë, por konfiguracioni i terrenit  
6 mund ta nxjerrë edhe 5 kilometra.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit zoti Veseli.

9 Po ju drejtohem tani kolegëve në Trupin Gjykues nëse kanë  
10 pyetje të tjera.

11 Kolegu që është ulur në të majtën time, do t'ju bëj disa  
12 pyetje të tjera.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Zoti Veseli, kam një pyetje.  
14 Sot, në faqen 60 të transkriptit rreshti 21, keni thënë kur po  
15 flisnit për ofensivën serbe rreth datës 18 prill, keni thënë  
16 "ne rezistuem". A mund të na tregoni sa ditë arritët të  
17 rezistonit përpara se t'ju duhej që të tërhiqeshit prej  
18 Zllashit?

19 Pë. Dy ditë. Por vetëm nuk jemi tërheq prej Zllashit, por  
20 jemi tërheq ma në brendësi të malit rreth Zllashit, a për  
21 ndryshe s'jemi tërheq prej Zllashit. Se regjionin e Zllashit  
22 nuk e kemi lëshu. Se i tillë ka qenë konfiguracioni i terrenit  
23 që kemi mund me organizu mbrojtje.

24 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po, e kuptoj. Por, kur ju  
25 është dashur të tërhiqeshit nga aty ku ishit, nga shtabi, sa

1 ditë rezistuat ju, i rezistuat ofensivës serbe, para se pastaj  
2 të ngjiteshit lart në bjeshkë? Ju kujtohet?

3 Pë. Shtabin e kemi leshu prej momentit kur nga tanku M-34  
4 serb ashtë gjuajt mbi shtabin dhe shkollën. Dhe s'kemi pas,  
5 ashtë dash me e lëshu.

6 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] E kuptoj shumë mirë. A ju  
7 kujtohet se kur në krahasim me ditën e parë të ofensivës, sa  
8 kohë kaloi?

9 Pë. Në fund të ditës së parë të ofensivës, na ashtë dasht --  
10 ne s'kemi pas ku të kthehemi në ato pikat tona, se faktikisht  
11 ato kanë qenë të asgjësuar, kanë qenë të pabanueshme.

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit, zoti Veseli.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit zoti Veseli. Kemi ardhur kështu në fund të  
15 dëshmisë suaj. Na keni treguar edhe më herët sot që është  
16 shumë e vështirë një gjë e tillë për ju. Ju falënderojmë për  
17 përpjekjen tuaj për të na dhënë këtë dëshmi këtu. Jam e sigurt  
18 që dëshmia juaj do të na ndihmojë në përpjekjen tonë për të  
19 gjetur të vërtetën.

20 DËSHMITARI: A mund diçka? A mund të flas?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Patjetër, sigurisht. Por në varësi të asaj që do të thoni  
23 sigurisht, por do t'jua jap fjalën, ju lutem flisni.

24 DËSHMITARI: Shumë shkurt. Unë ju jam mirënjohës ma së  
25 pari për konstruktivitetin e juaj dhe kam besim që jeni

Dëshmitari: Sejdi Veseli (Seancë e hapur)

Faqe 99

Pyetje nga Trupi Gjykses

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 luftëtarë që doni me zbulu të vërtetën. Qëndrimi im prej  
2 fillimi ka qenë shumë i singertë edhe pa marrë parasysh që ju  
3 jeni Panel Gjykses, këta janë Prokurorë, unë për shembull në  
4 se doni çdo herë mundeni me më llogarit një mik.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit zoti Veseli.

7 Atëherë, është fundi i dëshmisë suaj. Ju uroj një udhëtim  
8 të mbarë në shtëpi. Ju rikujtoj që, të mos ta diskutoni  
9 përmbajtjen e dëshmisë që keni dhënë këtu, me askënd. Do t'i  
10 lutem tani Asistentes së sallës që t'ju shoqërojë të dilni nga  
11 salla e gjyqit.

12 DËSHMITARI: Po i heq këto, po? Ju përshëndes.

13 [Dëshmitari largohet]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit zonja asistente e sallës.

16 Shumë mirë. Përpara se të ndërpresim punimet për sot, ju  
17 drejtohem palëve dhe të pranishmëve, Mbrojtjes së Viktimave,  
18 nëse kane çështje për të ngritur.

19 Zoti Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Asgjë të nderuar Gjykatës.

21 Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Mbrojtësja e Viktimave?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asgjë edhe nga ana e jonë.

1 Faleminderit

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, asgjë  
5 për momentin.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit z. Avokat i Mbrojtjes.

8 Në rregull atëherë. Duke qenë se nuk ka asnjë çështje për  
9 të ngritur, do të rifillojmë javën e ardhshme, kur do të  
10 dëgjojmë Dëshmitarin me numër 4849. Do të fillojmë në orën  
11 9.30, ditën e martë më 1 shkurt.

12 Si gjithmonë, falënderoj përkthyesit, stenografin, ekipin  
13 audio viziv dhe personelin e sigurisë për asistencën e tyre,  
14 si dhe palët dhe Mbrojtësen e Viktimave për pjesëmarrjen.

15 Këtu ndërpritet seanca deri javën e ardhshme.

16 --- Seanca mbyllet në orën 15.24

17

18

19

20

21

22

23

24

25